

**VENDIM**  
**Nr. 362, datë 26.4.2017**

**PËR MIRATIMIN E KONTRATËS NR. 5758 PROT., DATË 25.4.2017, NDËRMJET  
MINISTRISË SË FINANCIVE DHE BASHKIMIT TË SHOQËRIVE “ADMIRAL  
SPORTWETTEN”, GMBH, “ATSP”, SPOLKA AKCYJNA, “MC NETWORKING”,  
SH.P.K., “PËR NDËRTIMIN DHE MIRËMBAJTJEN E SISTEMIT QENDROR TË  
MONITORIMIT *ON-LINE* (SQMO) PËR INDUSTRIJË E LOJËRAVE TË FATIT NË  
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 12, të nenit 70, të ligjit nr. 155, datë 21.12.2015, “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të vendimit nr. 647, datë 14.9.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e mënyrës dhe të kriterëve të përzgjedhjes së operatorit që do të ndërtojë Sistemin Qendror të Monitorimit *On-line* (SQMO) si dhe autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurave të përzgjedhjes”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e kontratës nr. 5758 prot., datë 25.4.2017, ndërmjet Ministrisë së Financave dhe bashkimit të shoqërive “Admiral Sportwetten”, GmbH, “ATSP”, Spolka Akcyjna, “MC Networking”, sh.p.k., “Për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e Sistemit Qendror të Monitorimit *On-line* (SQMO) për industrinë e lojërave të fatit në Republikën e Shqipërisë”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**  
**Niko Peleshi**